KIRFN Interpretimi 1
Ndryshime në Detyrimet Ekzistuese të Nxjerrjes nga Përdorimi, Ristrukturimi dhe Detyrime të Ngjashme

Referenca

- SNRF 16 *Qiratë*
- SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*
- SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*
- SNK 16 *Aktivet afatgjata materiale (Toka, ndërtesa, makineri e pajisje)* (rishikuar në 2003)
- SNK 23 *Kostot e huamarrjes*
- SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve* (sipas rishikimit në 2004)
- SNK 37 *Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara*

Historiku

1 Shumë njësi ekonomike detyrohen të zbërthejnë, heqin dhe restaurojnë zëra të aktiveve afatgjata materiale si toka, ndërtesa, makineri e pajisje. Në këtë Interpretim detyrime të tilla trajtohen si 'nxjerrje nga përdorimi, restaurim dhe detyrime të ngjashme'. Sipas SNK 16, kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) përfshin vlerësimin fillestar të kostove të zbërthimit dhe heqjes së zërit dhe restaurimit të vendit në të cilin ai është vendosur, detyrimi për të cilin një njësie ekonomike i vjen si nga blerja e këtij zëri ose si një pasojë e përdorimit të zërit gjatë një periudhe të caktuar për qëllime të ndryshme nga prodhimi i inventarëve gjatë asaj periudhe. SNK 37 përmban kërkesat lidhur me matjen e detyrimeve të nxjerrjes nga përdorimi, restaurimin dhe detyrimeve të ngjashme. Ky Interpretim jep udhëzime lidhur me trajtimin kontabël të efektit të ndryshimeve në matjen e detyrimeve ekzistuese të nxjerrjeve nga përdorimi, restaurimi dhe detyrimeve të ngjashme.

Objekti

2 Ky interpretim zbatohet për ndryshimet në matjen e çdo nxjerrjeje nga përdorimi, restaurimi ose detyrim të ngjashëm ekzistues i cili njëkohësisht:

(a) të njohura si pjesë e kostos së një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) në përputhje me SNK 16 ose si pjesë e kostos së aktivit me të drejtë përdorimi në përputhje me SNRF 16; dhe

(b) është njohur si një detyrim në përputhje me SNK 37.

Për shembull, një detyrim për nxjerrje nga përdorimi, restaurimi ose detyrim i ngjashëm mund të ekzistojë për nxjerrjen nga përdorimi të një fabrike, rehabilitimin e dëmit mjedisor për industritë nxjerrëse, ose heqjen e pajisjeve.

Çështja

3 Ky Interpretim paraqet mënyrën se si duhet të kontabilizohet efekti i ngjarjeve në vijim, të cilat ndryshojnë matjen e një nxjerrjeje nga përdorimi, restaurimi ose detyrimi të ngjashëm ekzistues:

(a) një ndryshim në fluksin dalës të vlerësuar të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike (p.sh. flukse të mjeteve monetare) që kërkohen për të shlyer detyrimin;

(b) një ndryshim në normën aktuale të skontimit të bazuar në treg sipas përkufizimit në paragrafin 47 të SNK 37 (kjo përfshin ndryshimet në vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për detyrimin); dhe

(c) një rritje që pasqyron kalimin e kohës (e quajtur gjithashtu edhe si mos pranimi i zbritjes).

Konsensusi

4 Ndryshimet në matjen e një detyrimi për nxjerrjen nga përdorimi, restaurimi dhe detyrimin e ngjashëm ekzistues që rezulton nga ndryshimet në vlerësimin e kohës ose të shumës së flukseve dalëse të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike që kërkohen për shlyerjen e detyrimit, ose një ndryshim në normën e skontimit, duhet të trajtohen në përputhje me paragrafët e mëposhtëm 5–7.

5 Nëse aktivi përkatës matet duke përdorur modelin e kostos:

(a) subjekt i (b), ndryshimet në detyrim do t'i shtohen ose do t'i zbriten kostos së aktivit përkatës në periudhën aktuale.

(b) shuma e zbritur nga kosto e aktivit nuk duhet të tejkalojë vlerën e tij kontabël (neto). Nëse zbritja nga detyrimi tejkalon vlerën kontabël (neto) të aktivit, tejkalimi do të njihet menjëherë në fitim ose humbje.

(c) nëse rregullimi sjell një rritje në koston e një aktivi, njësia ekonomike duhet të marrë në shqyrtim faktin nëse ky është një tregues që vlera e re kontabël (neto) e aktivit mund të mos jetë plotësisht e rikuperueshme. Nëse ka një tregues të tillë njësia ekonomike duhet të testojë aktivin për zhvlerësim duke vlerësuar shumën e tij të rikuperueshme dhe duhet të kontabilizojë çdo humbje nga zhvlerësimi, në përputhje me SNK 36.

6 Nëse aktivi përkatës matet duke përdorur modelin e rivlerësimit:

(a) ndryshimet në detyrim ndryshojnë tepricën e rivlerësimit ose deficitin e njohur më parë për këtë aktiv, kështu që:

(i) një pakësim në detyrim (subjekt i (b)) do të njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse tek teprica e rivlerësimit në kapitalin neto, me përjashtim të asaj që do të njihet në fitim ose humbje në masën që ajo anulon një deficit rivlerësimi mbi këtë aktiv, të njohur më parë në fitim ose humbje;

(ii) një rritje në detyrim do të njihet në fitim ose humbje me përjashtim të asaj që do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe do të zvogëlojë tepricën e rivlerësimit brenda kapitalit, deri në masën e çdo teprice kreditore ekzistuese në tepricën e rivlerësimit që lidhet më atë aktiv.

(b) në rastin kur një pakësim në detyrim tejkalon vlerën kontabël (neto) që do të ishte njohur nëse aktivi do të mbahej sipas modelit të kostos, tejkalimi do të njihet menjëherë në fitim ose humbje.

(c) një ndryshim në detyrim është një indikacion që tregon se aktivi duhet të rivlerësohet me qëllim që të sigurojë se vlera kontabël (neto) nuk ndryshon shumë nga ajo që do të përcaktohej duke përdorur vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese. Çdo rivlerësim i tillë duhet të merret në konsideratë kur përcaktohen shumat që do të përfshihen në fitim ose humbje ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse sipas (a). Nëse një rivlerësim është i nevojshëm të gjitha aktivet e asaj klase duhet të rivlerësohen.

(d) SNRF 18 kërkon që zëra të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të paraqiten si nënzëra në pasqyrën që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse. Gjatë plotësimit të kësaj kërkese, ndryshimi në tepricën e rivlerësimit që vjen nga një ndryshim në detyrim, do të identifikohet veçmas dhe paraqitet si i tillë.

7 Shuma e amortizueshme e rregulluar e aktivit amortizohet përgjatë jetës së dobishme të aktivit. Prandaj, pasi aktivi përkatës ka mbërritur në fund të jetës së dobishme të tij, të gjitha ndryshimet e mëpasshme në detyrim do të njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Kjo është e zbatueshme sipas modelit të kostos dhe sipas modelit të rivlerësimit.

8 Shpërndarja periodike e zbritjes do të njihet në fitim ose humbje si shpenzim interesi nga detyrime të ndryshme nga ato që vijnë nga transaksione që përfshijnë vetëm marrjen e financimit kur ndodh dhe do të klasifikohet—duke zbatuar paragrafin 61 të SNRF 18—në kategorinë financiare të pasqyrës së fitimit ose humbjes. Nuk lejohet kapitalizimi sipas SNK 23.

Data e hyrjes në fuqi

9 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 shtator 2004 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Interpretim për

 © Fondacioni i SNRF-ve

një periudhë që fillon më parë se data 1 shtator 2004, ajo duhet të jap informacione shpjeguese për këtë fakt.

9A SNK 1 (rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Në përputhje me këtë u ndryshua paragrafi 6. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2009 e në vazhdim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.[1]

9B SNRF 16, e publikuar në janar 2016, ndryshoi paragrafin 2. Njësia ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

9C SNRF 18, i publikuar në prill 2024, ndryshoi paragrafët 6 dhe 8. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Periudha kalimtare

10 Ndryshimet në politikat kontabël duhet të kontabilizohen në përputhje me kërkesat e SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet.*[2]

[1] Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.

[2] Kur publikoi SNRF 18, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.